



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-06/01-9111/21 datë: 21.04.2021



Npi – 01/122 datë: 30.04.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -IV- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 30.04.2021 (e premte) në ora 14.00 h. në sallën e vogël të Kuvendit. Në mbledhje përveç anëtarëve të Komitetit për Komunitete: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, znj.Xhevahire Ramadani, dhe z.Arton Demiri, kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri, Nga zyra për Informim z.Shpëtim Gashi, drejtoresha e DPUKGJ-së znj.Shqipe Rexhaj si dhe drejtori i SHPRK-së z.Agron Beka (organizata për banim social dhe të drejtat pronësore). Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Rahman Kadrija i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Projektet e infrastrukturës në lagjet e komuniteteve (DPUKGJ),
3. Gjendja e përgjithshme në kushtet dhe masat e pandemisë Covid 19 (te komunitetet)
4. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
5. Të ndryshme.

Pas propozimit të rendit të ditës, nga Kryesuesi u kërkua që pasi që mungon procesverbali nga mbledhja e kaluar, si pikë e parë të jetë Informata lidhur me projektin për legalizimin e pronave të komuniteteve RAE në komunën e Shtimes pasi që në këtë mbledhje merr pjesë Agron Beka-drejtor SHPRK-së. Rendi i ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitet aprovoi Rendin e Ditës si vijon:**

1. Informatë lidhur me projektin për legalizimin e pronave të komuniteteve RAE në komunën e Shtimes,
2. Projektet e infrastrukturës në lagjet e komuniteteve (DPUKGJ),
3. Gjendja e përgjithshme në kushtet dhe masat e pandemisë Covid 19 (te komunitetet),
4. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
5. Të ndryshme.

Pika 1

Informatë lidhur me projektin për legalizimin e pronave të komuniteteve RAE në komunën e Shtimes

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrij; Para se të hapi diskutimin për këtë pikë, fjalën ja dha Agron Beka.

z.Agron Beka, drejtor SHPRK; Projekti është i financuar nga SIDA-suedeze dhe merret me legalizimin e pronave të komunitetit RAE . Kemi raportin që 356 mijë prona nuk janë të legalizuara. Legalizimi po shkon ngadalë prandaj jemi munduar ta gjejmë defektin që t'i ndihmojmë popullatës. Projekti shtrihet në 8 Komuna. Donatori kërkon që projekti të koncentrohet tek gratë dhe vajzat. Kërkesa kryesore e jona është që përmes përfaqësuesve të komuniteteve të kemi pjesëmarrje të grave në takim ku do të jepen sqarime. Do të kërkojmë nga urbanizimi formularët ku synojmë të zhvillojmë aktivitetet. Kemi bashkëpunëtorët tanë në terren, por kërkojmë mbështetjen tuaj për trajnimet që kemi planifikuar.

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Mund të bëhet vetëm legalizimi i shtëpisë dhe jo i pronës.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; A ka lehtësira për këto grupe të synuara sepse komunitetet RAE nuk janë në gjendje të përballojnë shpenzimet e matjeve gjeodezike dhe procedurave të tjera.

z.Agron Beka, drejtor SHPRK; Ligji parasheh kriteret dhe ne nuk mund të ndërhyjmë në çështjet e ligjit pavarësisht se kemi të bëjmë me komunitetet RAE.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrij; Kemi prona dhe shtëpi që nuk janë në emër të tyre, por në emër të serbëve që tani nuk mund të gjenden.

z.Agron Beka, drejtor SHPRK; Afati është deri 31.12.2021, për këtë projekt.

z.Muhamet Ademaj; Shumica e shtëpive janë pa leje ndërtimi, çka ndodh me to?

z.Agron Beka, drejtor SHPRK; Takimet do të fillojnë me popullatën muajin e shtatë dhe të tetë kurse tani do të bëjmë koordinimin me drejtoritë e PUKGJ.

Pika 2

Projektet e infrastrukturës në lagjet e komuniteteve (DPUKGJ)

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrij; Fjalën ja dha Shqipe Rexhaj.

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Të gjitha projektet e infrastrukturës që po zhvillohen po prekin komunitetet në përgjithësi. Tani për tani kemi projektin për pastrimin e lumit, ku preken familjet e komuniteteve pakicë. Kemi projekte në fshatin Vojnoc për rrugën që është në procedurë si dhe në fshatin Gjurmoc-projekte dy vjeçare.

z.Ruzhdi Brahimi; Rruga "Enver Gashi", në Shtime ende nuk ka ndriçim publik.

znj. Shqipe Rexhaj, drejtoresh e DPUKGJ; Ndriçimi është në kompetencë të Drejtorisë për Shërbime Publike.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Gjithashtu edhe rruga "Hysiqi" ka mbetur pa u asfaltuar ende edhe aty ka shumë familje të komuniteteve.

z.Muhamet Ademaj; Kemi komunitetet që jetojnë të pandara nga shumica. Është mirë që nëse ka rrugica të komunitetit RAE të rregullohen dhe të ndriçohen.

Pika 3

Gjendja e përgjithshme në kushtet dhe masat e pandemisë Covid 19 (te komunitetet)

Kryesuesi z.Rrahman Kadrija; Deri më sot kemi të infektuar mbi 10 persona por pa raste tragjike. Shërimi ka pasur kosto dhe rekomandojmë që t'ju ndihmojmë këtyre rasteve.

z.Arton Demiri; Komunat tjera kanë zbatuar pagesën prej 100€ për secilin rast nga covid 19.

Kryesuesi z.Rrahman Kadrija; Kemi kërkuar që të ndihmohen dy familje: Bedredin Abazi dhe Gazmend Ilazi me shumën 1000 € për ndihmë pasi që ka filluar ndërtimi i shtëpive të tyre përmes

donatorëve. Po ashtu sot përmes një donatori kemi hapur një pus për familjen e Bedredin Abazit në Vojnoc.

Lidhur me këtë pike KPK rekomandon që DSHMS-ë, nga buxheti subvencione, të ndihmojë me prioritet rastet që dëshmojnë se kanë kaluar covid 19 dhe të prezantojnë dëshmi për shpenzimet.

Pika 4

Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Fjalën ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Gjatë këtij muaji nuk ka pasur të kthyer dhe as të riatdhesuar. Nga bashkëpunimi me IOM-in kemi hartuar 10 kërkesa dhe kemi plotësuar 10 aplikacione për ndihmë për projektet e bizneseve familjare edhe pse kemi marrë njoftimin se nga komuna e Shtimes, këtë vit, nuk mund të ndihmohen më shumë se 2 familje. IOM-i bashkë me ZKKK-në do të vizitojnë këto familje dhe pastaj mbetet që IOM-i të përzgjedhë 2 familje që do të jenë në gjendje të participojnë 10% nga vlera e përfutur për projekt e që mund të jetë deri në 5 mijë euro. Kemi kërkesë nga OJQ "VORAE" për angazhim në punë praktike me pagesë të 5 studenteve apo nxënësve në institucionet publike të komunës. Kemi konfirmuar se 2 do t'i angazhojmë në ZKKK, një në QPS, një në QKMF dhe një në DZHE. Shtëpitë nga MPMS që kanë filluar në 2019, ende nuk janë të përfunduara plotësisht edhe pse tanë kanë filluar të përmbyllen punët e mbetura. Kemi ende 3 familje me qira mujore nga 100€ në muaj. 2 familje janë nga fshati Gjurmoc të strehuara qysh nga vërshimet dhe një që e kemi tani e disa vite. Kemi kërkesa të shumta për ndihmë, sidomos për ndihmë mjekësore dhe riparim të shtëpive. Do të bëjmë përzgjedhjen dhe do t'i realizojmë ato ma prioritetet pasi që kemi të alokuara për këtë periudhë 2 mijë euro.

Pika 5

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.


z.Arton Demiri: Kërkoj që nëse mund të përfshihet Driton Demiri në listën e IOM-it për projekt pasi që merret me punët e saldimit dhe nuk ka mundësi punësimi.

z.Ruzhdi Brahimi: Kërkoj që mos t'i paguhet edhe më tej qiraja Elmi Jakupit pasi që shtëpia po i ndërtohet dhe tani edhe djemtë ju kanë rritur për punë.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija mbledhjen e përfundoi në ora 15.30 h.

Procesmbajtës

Ibrahim Demiri



Kryesuesi i Komitetit

Rrahman Kadrija

